

UDHËZIM

Nr. 38, Datë 05.08.2013

“PËR VEPRIME TË KOMITETIT SHQIPTAR TË BIRËSIMIT, PËRPARA FILLIMIT TË PËRPUNIMIT TË TË DHËNAVE PERSONALE”

Mbështetur në shkronjën “c” të pikës 1 të nenit 30 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;

UDHËZON:

1. Në përputhje me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale, dhe qëllimin e këtij udhëzimi, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:
 - a) “Subjekt i të dhënave personale” janë birësuesi/t dhe i/e birësuar/a;
 - b) “Kontrollues i të dhënave personale” është Komiteti Shqiptar i Birësimit dhe agjencitë e ndërmjetësimit.
2. Kontrolluesit mund të përpunojnë të dhëna personale të birësuesve dhe të birësuarve vetëm:
 - a) nëse subjekti i të dhënave personale ka dhënë pëlqimin me shkrim, veprim i cili për përpunimin e të dhënave sensitive mund të revokohet në çdo moment;
 - b) për të mbrojtur interesat jetikë të të birësuarit;
 - c) për përmbushjen e veprimtarisë së punës së Komitetit Shqiptar të Birësimit;
 - d) nëse është thelbësore për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave legjitime të Komitetit Shqiptar të Birësimit.
3. Kontrolluesit në kryerjen e procedurave të birësimit;
 - a) përpunojnë të dhëna personale në përputhje me ligjet respektive;
 - b) grumbullojnë të dhëna vetëm për qëllime të birësimit të fëmijës;
 - c) mbledhin të dhëna të sakta dhe në përputhje me qëllimin e caktuar pa e tejkaluar atë;
 - d) bëjnë përditësimin e të dhënave;
 - e) bëjnë fshirjen apo korigjimin e të dhëna që i idendifikojnë të pasakta apo të paplota ose kur i kërkohet nga subjektet e të dhënave paraprakisht vlerësojnë nëse duhen kryer këto veprime;
 - f) mbajnë të dhënat në atë formë, që të lejojnë identifikimin e subjekteve të të dhënave për një afat kohor të caktuar deri në përmbushjen e qëllimit për të cilin ato janë mbledhur ose përpunuar.
4. Kontrolluesit gjatë përpunimit të të dhënave personale, marrin masa organizative dhe teknike për të mbrojtur të dhënat në dokumentacionin birësues në përputhje me ligjet respektive dhe udhëzimet nr.21 dhe 22, datë 24.09.2012, respektivisht, “Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga kontrolluesit e mëdhenj” dhe “Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga kontrolluesit e vegjël”, të ndryshuar .
5. Punonjësit e kontrolluesit që për shkak të detyrës kanë informacion për birësimin, për të dhënat që idendifikojnë fëmijën, prindërit biologjikë dhe birësuesit, nënshkruajnë deklaratë për ruajtjen e konfidencialitetit dhe besueshmërisë gjatë dhe pas ushtrimit të funksionit.
6. Kontrolluesit në përputhje me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale detyrohen të zbatojnë të drejtat e subjektit të të dhënave, në përputhje me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.

7. Mos zbatimi i detyrimeve të përcaktuara në këtë udhëzim dënohet sipas nenit 39 të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, i ndryshuar.

8. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Komiteti Shqiptar i Birësimit dhe Agjencitë e Ndërmjetësimit.

Udhëzimi nr. 8, datë 31/08/2010 “Për veprime të kontrolluesit, komiteti shqiptar i birësimit, përpara fillimit të përpunimit të të dhënave personale”, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KOMISIONERI

Flora Çabej (Pogaçe)